

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË
KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE PËR VITIN 2021

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur AKEP-in si autoritet i pavarur për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe postare, si dhe për ruajtjen e ekuilibrit ndërmjet interesave të konsumatorëve, shtetit dhe sipërmarrësve në këtë sektor;

Duke theksuar se rritja e vëllimit të pakove postare gjatë vitit 2021, e nxitur edhe nga tregtia elektronike, ka çuar në rritjen e ndjeshme të operatorëve të rinj ofrues të shërbimeve të dorëzimit të pakove postare, ku nga 26 operatorë që numëroheshin deri në fund të vitit 2020, ky numër ka arritur në 34 operatorë në fund të vitit 2021;

Duke theksuar se gjatë vitit 2021 trafiku i internetit broadband nga rrjete fikse pati një rritje tepër të lartë, rreth 56% më shumë se viti 2020, çka tregon se pajtimtarët e këtij shërbimi e kanë shfrytëzuar këtë rrjet për të aksesuar shërbimet e tyre financiare, informative, sociale, shëndetësore në mënyrë sistematike dhe të qëndrueshme;

Duke theksuar se nga 75% që ishte mbulimi i territorit me rrjete LTE 4G në vitin 2019, ai shkoi drejt kompletimit tërësor me afro 96% në vitin 2021, si dhe duke nënvizuar faktin që përpjesëtime gjithmonë e më të mëdha po merr investimi në fibrën optike për sa i përket cilësisë së rrjeteve për ofrimin e aksesit broadband në rrjetet fikse;

Duke theksuar se nxitja e investimeve duhet të ketë në fokus zhvillimin e qëndrueshëm digjital të vendit, rritjen e cilësisë së shërbimit, garantimin e të drejtave të konsumatorëve, si dhe nxitjen e konkurrencës së ndershme dhe të lirë në treg;

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e AKEP-it për vitin 2021 dhe vlerëson:

Punën e bërë për zbatimin e marrëveshjes rajonale të romingut, e cila ka bërë të mundur “Roaming like at home” në Ballkanin Perëndimor nga 1 korriku i vitit 2021 duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në reduktimin e tarifave të shërbimeve roming për pajtimtarë të vendeve të Ballkanin Perëndimor.

Impenjimin në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit duke bërë të mundur që nga data 1 janar 2021 Posta Shqiptare të mos aplikojë tarifën e dorëzimit për objektet postare, paket e vogla apo kolipostat që vijnë nga jashtë vendit.

Monitorimin e bërë për përmbushjen e rekomandimeve nga sipërmarrësit e rrjeteve celulare për shkeljet e konstatuara në zbatimin e rregullores së portabilitetit të numrit, duke bërë të mundur që pajtimtarët të ushtrjnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular.

Bashkëpunimin me Autoritetin e Konkurrencës për çështje me interes të përbashkët që lidhen me zbatimin e legjislacionit në fuqi për konkurrencën e sektorit të komunikimeve elektronike dhe të shërbimit postar.

Punën e bërë dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, shoqatat e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si dhe me operatorët celularë për hartimin e kontratave specifike për përdoruesit me aftësi ndryshe.

Punën e bërë për nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit me AMA-n, që ndër të tjera përcakton bashkëpunim në çështje me rëndësi, si: lufta kundër paligjshmërisë në transmetimet audiovizive, lirimi i brezit 700 MHz (brezi DD2), ndjekja në vijueshmëri e problemeve me interferencat etj.

Bashkëpunimin e AKEP-it si pjesë e grupit të punës të ngritur nga MIE-ja në kuadër të harmonizimit të legjislacionit të fushës së komunikimeve elektronike në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike.

Kuvendi i Shqipërisë për vitin 2022 rekomandon që AKEP-i të angazhohet veçanërisht në këto aspekte të veprimtarisë së tij:

1. Të bashkëpunojë ngushtë me Autoritetin e Konkurrencës për të shmangur krijimin e një tregu oligopol në vend, si dhe për të mundësuar zhvillimin e një konkurrence të ndershme në

tregun e komunikimeve elektronike në Republikën e Shqipërisë, duke pasur parasysh veçanërisht edhe situatën e re të krijuar në tregun e sipërmarrësve të rrjeteve celulare.

2. Të ndjekë zbatimin e Rregullores për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe Përdoruesve të Shërbimeve të Komunikimeve Elektronike Publike nga ana e sipërmarrësve, veçanërisht sa u takon rregullave për trajtimin e ankesave nga operatorët, saktësisht për kohëzgjatjen, rinovimin dhe përfundimin e kontratave, rregullave për aksesin në shërbimet e emergjencës dhe përcjelljen e informacionit të vendndodhjes etj., referuar hyrjes në fuqi më 1 shkurt 2022 të kësaj rregulloreje, e cila synon një mbrojtje më të mirë të të drejtave të konsumatorit dhe pajtimtarëve.

3. Të ndjekë dhe të monitorojë me rigorozitet përmbushjen e rekomandimeve dhe detyrave të dhëna për secilin operator, në funksion të zbatimit të rregullores të portabilitetit të numrit, duke bërë të mundur që pajtimtarët të ushtrojnë të drejtën e tyre të portimit të numrit celular sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në aktet rregullatore, referuar edhe numrit të lartë të ankesave nga pajtimtarët në lidhje me refuzimin e kërkesave për portimin e numrit celular, si dhe t'u kushtojë vëmendje ankesave të pajtimtarëve lidhur me respektimin nga ana e operatorëve të sasive të GB (*gigabyte*) internet në dispozicion të pajtimtarëve sipas paketave përkatëse.

4. Në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, të monitorojë përmbushjen e detyrimit nga Posta Shqiptare të dorëzimit të pakove në adresën e individit, si një kërkesë ligjore dhe e drejtë e konsumatorit, si dhe aplikimin e ndarjes së llogarive në të gjithë sistemin postar.

5. Të bashkëpunojë me MIE-in dhe me konsulentët e përzgjedhur për realizimin në kohë të projektit “Zhvillimi i Atlasit të Broadband të Shqipërisë dhe përdorimi i tij në sektorin publik dhe privat”, i cili ka për qëllim zhvillimin dhe përditësimin e sistemit Atlas me informacion deri në përdoruesin fundor, informacionin për përdorimin e internetit me brez të gjerë në Shqipëri, ofruesit e rrjetit në një zonë të caktuar, etj.

6. Të bashkëpunojë gjatë vitit 2022 me AMA-n për finalizimin e procesit të lirit të brezit DD2 në fund të qershorit 2022 dhe më tej marrjen në administrim të këtij brezi.

7. Të vijojë punën për nënshkrimin e marrëveshjes ndërkufitare me Republikën e Maqedonisë së Veriut nën dritën e ndryshimeve të reja të menaxhimit të spektrit, si dhe mundësinë për t'iu bashkuar marrëveshjeve rajonale për brezat 4G, 5G etj.

8. Të vijojë të ndjekë me përparësi problematikën për sistemim të kabllave ekzistuese në shtyllat e energjisë elektrike, duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet OSHEE-së dhe operatorëve të rrjeteve fikse për rregullimin e përdorimit të infrastrukturës pasive, mbështetur në aktmarrëveshje ndërmjet palëve, si dhe duke propozuar ndryshime ligjore/nënligjore për zgjidhjen e këtij problemi në terma afatgjatë. Gjithashtu, edhe përdorimi i infrastrukturës së përbashkët vijon të mbetet problem duke vendosur në të njëjtin vend 3 apo 4 shtylla të operatorëve të ndryshëm të rrjeteve fikse.

9. Të vijojë të bashkëpunojë me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me të gjitha palët e tjera të interesuara për gjetjen e zgjidhjeve sa më të mira operationale, teknike dhe financiare për të garantuar ofrimin e shërbimeve sa më të dobishme për akses të barabartë për përdoruesit me aftësi ndryshe.

10. Të impenjohet intensivisht për të bërë të mundur zgjidhjen e problematikës së telefonatave të padëshiruara të kompanive të marketingut në drejtim të pajtimtarëve, duke bërë të mundur që pajtimtarët të kenë mundësi të mos marrin thirrje të pakërkuara nga kompanitë e marketingut.

11. Të ketë prioritet të punës bashkëpunimin me MIE-në për ndryshimet ligjore në ligjin e komunikimeve elektronike, në mënyrë që këto ndryshime të jenë në përputhje me Kodin e ri European të Komunikimeve Elektronike duke krijuar një kuadër rregullator efektiv për zhvillimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të telekomunikacionit dhe në koherencë me sfidat në fushën e komunikimeve elektronike.

12. Të fokusohet në realizimin e një vlerësimi të hollësishëm dhe me impakt afatgjatë të parametrave, kapaciteteve dhe instrumenteve tekniko-ligjore për sigurinë e rrjeteve dhe sistemeve kritike në AKEP, me qëllim parandalimin dhe asgjësimin e sulmeve kibernetike;

13. Të bashkëpunojë me AMA-n dhe Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) për qasje proaktive dhe sa më efektive në parandalimin e rasteve të gjuhës së urrejtjes dhe të dhunës në portalet e ndryshme online.

14. Të bashkëpunojë me të gjithë aktorët dhe institucionet përgjegjëse për të bërë të mundur që të mos kemi shkolla në vend pa akses në internet sipas kushteve teknike dhe parametrave përkatës.

Miraturar në datën 30.5.2022.

ZËVENDËSKRYETARE
Ermonela Felaj (Valikaj)